

REPUBLIKA E SHQIPERISE

UJESJELLES KANALIZIME TIRANE

## RELACIONI TEKNIK

Objekti: Punime ndertimore per spostimin e rrjetit kryesor të ujësjellës-kanalizime në objektin: "Reabilitim i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta-Rrethrotullimi Shqiponja Loti 1"

Pergatiti : "A & E Engineering" Sh.p.k.




Reabilitimi i segmentit rrugor "Mbikalimi I Pallatit me Shigjeta-Rrethrotullimi Shqiponja Loti 1" eshte nje nder kryqezimet kryesore te qytetit te Tiranes. Ne kete kryqezim eshte perqendruar trafiku kryesor i hyrjes dhe i daljes per qytetin e Tiranes, sikurse edhe trafiku qe vjen nga Unaza e Tiranes. Ne menyre qe ti jepet nje zgjidhje perfundimtare ketij fluksi automjetesh, eshte parashikuar ne Projektin e Zbatimit te kontrates sone kalimi me galeri nentokesore.

Pasi kemi shqyrtuar materialin e derguar nga Ujeselles Kanalizime Tirane, mbi projektin e spostimit te Linjes se shkarkimit me box beton / arme 3.0x2.0m dhe te linjes se ujesellesit me tubacion celiku D=1016mm lind e domosdoshme marrja e masave mbrojtese inxhinierike.


### Mbrojtja me pilota

Ne planimetrine e meposhtme paraqitet linja e spostuar e boxit 3x2 dhe tubacionit te celikut.



Sikurse shihet ndertimi i boxit beton/arme 3x2m eshte shume prane galerise nentokesore qe mundeson kalimin e automjeteve te ardhur nga autostrada Durrës – Tirana drejt Unazës Veriore. Nga azhornimet e marra nga UKT, verehet se kanalet egzistuese te shkarkimit te ujrale jane ne gjurmet ne te cilat do te ndertoohen galerite e kalimit te automjeteve. Me grafik punimesh, spostimi i kanalizimit duhet te behet para ndertimit te galerise ne menyre qe te hapet sheshi i ndertimit. Kjo do te thote qe pasi te ndertohet boxi 3x2m do te jete e nevojshme qe shume afer me te, te kryhen germime deri ne 10m nen tabanin e boxit, per ndertimin e galerive nentokesore. Germimi qe do te realizohet do te kete nje skarpate shume te pjerret rreth 1:3 dhe nje skarpate e tille ne germim perballohet vetem nga terrene shume te forta me baze shkembore.


Ne studimin gjeologjik te projekt zbatimit, jane paraqitur shtresat tokesore ne te cilat mbeshtetet objekti qe do te ndertohe. Sipas ketij studimi shtresat perbehen kryesisht nga suargjila te mesme pluhurore, perzjerje e materialit suargjil me material zhavoror, depozitime aluviale te terraces se pare te Lumit Tirana etj. dhe pervec kesaj niveli I ujrale nentokesore eshte 5.2m nen nivelin e terrenit egzistues.



Faktoret e siper permendur shprehin qarte se situata duhet shqyrtuar ne menyre serioze dhe duhet te merrem masa mbrojtese inxhinierike, per mbrojtjen e skrapatave. Vetem me mbrojtjen e skrapatave nga rreshkitja e mundshme mund te sigurojme ndertimin e boxit 3x2m, i cili ne kohen e germimit do te jete edhe ne perdorim, me fluks ujtrash te

konsiderueshem, por njekohesisht edhe punimet e reja nga permbytje te mundshme ne rast demtimi te boxit.

Nga sa me siper, per mbrojtjen e boxit 3x2m gjate germimeve nga rreshkitjet e mundshme, eshte e domosdoshme ndertimi i perdes me pilota.




Ne profilin e mesiperme eshte paraqitur mbrojtja me pilota qe propozohet nga ana jone.


Ne prerjen e mesiperme eshte paraqitur edhe tubacioni i celikut, i cili per nje gjatesi rreth 40m eshte afer godinave egzistuese. Germimi per tubacionin ne kete zone do te kete nje skarpate me pjerresi 1:5, e cila eshte shume e pjerret dhe nuk eshte e pershtatshme per perberjen gjeologjike te kesaj zone. Nese nuk merren masat e nevojshme mbrojtese inxhinierike, do te kete rreshkitje te skarpates. Kjo do te sillte si pasoje ulje te themelit te godinave ngjitur duke u pasuar me demtime te tjera fizike te tyre. Pikerisht per te evituar kete fakt kemi propozuar mbrojtjen e godinave egzistuese me nje perde pilotash gjate ndertimit te linjes se ujesjellesit.

## Riveshja e shtresave asfaltike

Per shkak te kompleksitetit te ndertimit te kesaj vepre si dhe sheshit te ndertimit te rrahur nga nje trafik i vazhdueshem te cilin nuk mund ta ndalonim, por vetem ta devijonim, ndertimi I objektit eshte parashikuar me fazat e ndertimore. Gjate ketyre fazave e ndertimore behet devijimi I trafikut te automjeteve sipas nje plani te caktuar duke krijuar fronte pune. Devijimi I trafikut, per shkak se objekti ndodhet brenda qytetit kalon ne rruge te asfaltuara. Punimet per spostimin e kanalizimit te UKT-se prekin gjurmen ekzistuese te rruges se asfaltuar, ne kete rruge eshte parashikuar te behet devijimi I trafikut te automjeteve ne nje nga fazat e ndertimore. Per kete arsyen eshte e domosdoshme te behet rikthimi ne gjendjen e meparshme te rruges, pas nderhyrjes per punimet e spostimit te UKT-se.



## Hidroizolimi




Sikurse shihet edhe ne planimetrine e mesiperme, Trafiku I automjeteve me drejtim nga Unaza Jugore drejt Unazes Veriore; nga Unaza Veriore drejt Autostrades Tirane-Durresit dhe nga Autostrada Durres-Tirane drejt Unazes Jugore behet me nekalim me galeri ne nivelin e pare nentokesor.

Trafiku I automjeteve me drejtim nga Unaza Jugore drejt autostrades Tirane – Durres behet me nenkalim me galeri ne nivelin e dyte nentokesor.

Trafiku I automjeteve me drejtim nga Autostrada Durres-Tirane drejt Unazes Veriore behet me kalim ne nivelin e dyte nentokesor.

#### Sekcioni -1



Ne prerjen terthore me siper eshte paraqitur pjesa ne te cilen kemi tre galeri nentokesore ku kuota e kalimit per galerine qe ndodhet me poshte eshte deri -13m nga niveli I rruges ( terreni egzistues). Kuptohet qe kuota e germimit eshte akoma me poshte duke shkuar ne -15m. Pra strukturat e nenkalimit te automjeteve do te jene nen veprimin e ujrave nentokesore. Per nga rendesia qe veprat kane, jane marre te gjitha masat e nevojshme per mbrojtjen e tyre nga ujrat nentokesore duke bere hidroizolimi sa me te mire te siperfaqeve te betonit, por njekohesisht edhe duke trajtuar ujrat nentokesore me sisteme drenazhimi.

Duke u nisur nga rendesia e vepres dhe nga pamundesia per te riparuar nje dem te mundshem ne te ardhmen, propozojme te behet edhe hidroizolimi i kanalit te spostuar te UKT, box beton/arme 3.0x2.0m me Lyerje me dy duar bitum dhe 1 shtrese karton katrama. Ne kete menyre do te kemi nje siguri me te madhe per eliminimin e rrjedhjeve nentokesore te ujrave qe kalojne ne kete linje.

Pergatiti : "A & E Engineering" Sh.p.k.

Ing. Entela Çano

